



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE  
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR  
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

**Numri:** KSC-BC-2020-05  
**Prokurori k. Salih Mustafës**

**Vendosi:** Gjykatësi i procedurës paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore** Dr. Fidelma Donlon

**Pjesëmarrës parashtrues:** Prokurori i Specializuar

**Data:** 2 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i redaktuar publik i**

**'Parashtrimi të Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesat në lidhje me të',  
parashtrimi KSC-BC-2020-05/F00002 i datës 14 shkurt 2020**

**me shtojcën publike 1**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të të akuzuarit**

Xhulius von Bone

## A. HYRJE

1. Në pajtim me nenin 38(4) të Ligjit<sup>1</sup> dhe rregullën 86(2)-(3) të Rregullores,<sup>2</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') parashtron për konfirmim një aktakuzë kundër Salih MUSTAFËS, gjithashtu i njohur si 'Cali' ose 'komandant Cali', në lidhje me krimet e kryera në Zllash, Kosovë, në prill 1999 ('Aktakuza').<sup>3</sup> Aktakuza dorëzohet së bashku me materialin provues<sup>4</sup> dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.<sup>5</sup>

2. Z. MUSTAFA u lind më 1 janar 1972 in Prishtinë, Kosovë. Aktakuza dhe materiali provues tregojnë se ekziston dyshim i bazuar mirë<sup>6</sup> se z. MUSTAFA ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e krimeve të luftës brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake që ta konfirmojë Aktakuzën.

3. Duke u bazuar në nenin 3(8)(a), për arsye të sigurisë dhe të administrimit të duhur të drejtësisë, ZPS-ja bën kërkesë për caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës në lidhje me këtë fazë dhe të gjitha fazat e mëtejshme të procesit që buron prej kësaj aktakuze ose që ka lidhje me të.

4. Gjithashtu, me t'u konfirmuar Aktakuza, ZPS-ja kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake (i) të lëshojë një fletarrestim dhe një urdhër për transferim të z. MUSTAFA, në pajtim me nenet 39 dhe 41 dhe rregullat 30-33, 37, 39, 48, 50, 53, 55, dhe 86(6)(b); (ii) në pajtim me nenet 23, 35(2) dhe 39 dhe rregullat 30, 80, dhe 88(2), të

---

<sup>1</sup> Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). Nëse nuk përcaktohet ndryshe, kurdoherë që përmendet 'neni/nenet' është fjala për Ligjin.

<sup>2</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev1/2017, 5 korrik 2017 ('Rregullorja'). Nëse nuk përcaktohet ndryshe, kurdoherë që përmendet 'rregulla/rregullat', është fjala për Rregulloren.

<sup>3</sup> *Shih* Shtojcën 1. Në bazë të rregullës 86(1), Prokurori i Specializuar ka njoftuar Kryetaren e cila cakton një gjykatës të procedurës paraprake në përputhje me nenin 33(1)(a).

<sup>4</sup> Materiali mbështetës është dorëzuar si paketë e veçantë përmes Legal Workflow.

<sup>5</sup> *Shih* Shtojcën 2. *Shih gjithashtu* rregullën 86(3)(b).

<sup>6</sup> Neni 38(4) dhe rregulla 86(1). *Shih gjithashtu* Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, nr.04/L-123, Kodi i Procedurës, 2012 ('KPP'), neni 19(1.12) ('Dyshimi i bazuar mirë - nënkupton ngritjen e aktakuzës. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindnin një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri').

lëshojë një urdhër për mosnxjerrjen publike të Aktakuzës dhe dokumenteve apo informacionit në lidhje me të, deri në një urdhër të dytë; dhe (iii) në pajtim me nenet 23, 35(2) dhe 39 dhe rregullave 30, 80, dhe 105, të urdhërojë mosnxjerrjen e identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave në materialin mbështetës deri pasi të jenë urdhëruar masat e përshtatshme mbrojtëse.

#### B. URDHËR PËR LËSHIMIN E FLETARRESTIMIT DHE URDHËRIT TË TRANSFERIMIT

5. Kushtet e nenit 41(6) për arrestimin dhe paraburgimin e z. MUSTAFA janë përmbushur:

- i. Materialet mbështetëse provojnë ekzistencën e dyshimit të bazuar<sup>7</sup> se z. MUSTAFA ka kryer krime brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, që janë paraqitur në Aktakuzë dhe sikurse kërkohet prej nenit 41(6)(a); dhe
- ii. Plotësohen të tri arsyet alternative të renditura në nenin 41(6)(b). Ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se (1) ekziston rreziku i arratisjes; (2) z. MUSTAFA do të pengojë ecurinë e procedimit penal, ndër të tjera duke ndikuar ndaj dëshmitarëve, viktimave ose bashkëkryesve; dhe (3) pesha e krimit ose mënyra apo rrethanat e kryerjes së krimit dhe veçoritë individuale të z. MUSTAFA, veprimet e tij në të shkuarën, mjedisi dhe rrethanat në të cilat jeton ose rrethana të tjera personale tregojnë se ekziston rreziku që ai të kryejë sërish veprën penale, ose të kryejë një krim të cilin ka kërcënuar se do ta kryejë. [REDAKTUAR].<sup>8</sup>

#### 1.Z. MUSTAFA përbën rrezik arratisjeje<sup>9</sup>

6. Sapo të vihet në dijeni për akuzat kundër tij në lidhje me krimet e rënda dhe dënimet e rënda përkatëse për këto krime, z. MUSTAFA ka motivin që t'i shmangët gjykimin dhe rrezikut të shpalljes fajtor. Motivi i tij për tu arratisur mund të ndikohet

---

<sup>7</sup> [REDAKTUAR].

<sup>8</sup> [REDAKTUAR].

<sup>9</sup> Neni 41(6)(b)(i).

edhe nga dijenia që ka për vendimet e fajësisë të raportuara publikisht të komandantëve të mëparshëm të Zonës Operative të Llapit, Rrustem MUSTAFA, Latif GASHI dhe Nazif MEHMETI për krime të kryera kundër personave të ndaluar nga UÇK-ja në pjesë të tjera të Zonës Operative të Llapit.<sup>10</sup> Individët e lartpërmendur u akuzuan për krime të ngjashme të rënda me ato të paraqitura në këtë Aktakuzë.<sup>11</sup>

7. Z. MUSTAFA ka gjithashtu mjetet dhe mundësinë për t'iu shmangur drejtësisë. Z. MUSTAFA ka qenë komandant i lartë në UÇK. Ai aktualisht punon [REDAKTUAR] në Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës.<sup>12</sup> Për këtë arsye, ai bën pjesë në aparatin e sigurisë dhe inteligjencës së Kosovës dhe ka një rrjet të gjerë dhe mjete e burime të konsiderueshme për t'i ikur drejtësisë. Gjithashtu, z. MUSTAFA nuk ka probleme fizike ose shëndetësore të njohura që mund të kufizonin aftësinë e tij për të udhëtuar dhe posedon pasaportë kosovare e cila do t'i mundësonte të arratisesh menjëherë në shtetet ku nuk i kërkohet vizë.

## **2.Z. MUSTAFA mund të pengojë ecurinë e procedimit penal<sup>13</sup>**

8. Veprimet dhe sjellja e mëhershme e z. MUSTAFA, ndër të cilat edhe ato që paraqiten më poshtë, dëshmojnë për mundësinë e rrezikut të ndërhyrjes së tij ndaj dëshmitarëve, viktimave ose bashkëkryesve dhe ndryshe të pengimit të procesit. Gjithashtu, ai ka motivin, mjetet dhe mundësinë për këtë.<sup>14</sup>

9. Gjatë gjykimit të grupit të Llapit përmendur më lart, një numër dëshmitarësh refuzuan të bashkëpunonin, ose nuk u paraqitën në gjykim, apo e tërhoqën dëshminë si pasojë e frikësimit. Procesi gjyqësor i grupit të Llapit u karakterizua nga kërcënimet dhe frikësimet kundër dëshmitarëve. Ndonëse nuk ishte palë në këtë proces, z. MUSTAFA kishte qenë komandant i njësitit gueril BIA, njësit i Zonës Operative të Llapit dhe vartës i drejtpërdrejtë i komandantit të Zonës Operative të Llapit Rrustem

<sup>10</sup> Zllashi gjithashtu ndodhet në rajonin e operacioneve të Zonës Operative të Llapit.

<sup>11</sup> Shih *Prokurori k. Rrustem MUSTAFËS, Latif GASHTI dhe Nazif MEHMETIT*, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës, me datë 7 qershor 2013, P. nr. 448/2012. Rasti njihet si gjykimi i "Grupit të Llapit".

<sup>12</sup> Shih transkriptin e intervistës së ZPS-së me të dyshuarin [REDAKTUAR], pjesa 1, f.5.

<sup>13</sup> Neni 41(6)(b)(ii).

<sup>14</sup> Shih paragrafët 6-7 më lart.

MUSTAFA, i cili nuk u shpall fajtor. Kërcënimet dhe frikësimet në atë proces penal e penguan procesin. Rrjedhimisht ka arsye të besohet se meqenëse ka qenë oficer i lartë i UÇK, z. MUSTAFA mund të përpiqet të ndikojë mbi dëshmitarët në të njëjtën mënyrë. Kjo mbështetet nga fakti se një numër dëshmitarësh të intervistuar së fundmi nga ZPS-ja kanë shprehur frikën për hakmarrje kundër tyre dhe familjeve të tyre në rast se japin informata që mund të inkriminojnë ish-anëtarë të UÇK-së.

10. Sapo z. MUSTAFA të informohet për akuzat në Aktakuzë, ai mund [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR],<sup>15</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. Duke marrë parasysh [REDAKTUAR], ekzistojnë arsye për të besuar që z. MUSTAFA mund të përpiqet të ndërhyjë ndaj tyre.

11. Gjithashtu, [REDAKTUAR].<sup>16</sup> Deklarata të tilla tregojnë se Salih MUSTAFA mund të përpiqet të pengojë ecurinë e procedimit penal.

### **3. Ekzistojnë arsye për të besuar se z. MUSTAFA mund të kryejë krim**

12. Përtej natyrës së vetvetishme kriminale të orvatjeve për të ndërhyrë ndaj administrimit të drejtësisë, duke parë sjelljen e z. MUSTAFA n të kaluarën, besohet se ai është në gjendje të kryejë akte kriminale. Krahas pretendimeve të rënda për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme, besohet se më herët ai u është mburrur [REDAKTUAR] në lidhje me serbët që ai dhe anëtarët e njësitit të tij BIA kishin ekzekutuar.<sup>17</sup> Bazuar në sjelljen e tij në të kaluarën, ekziston rrezik real që ai të kryejë krime të tjera për t'iu shmangur ballafaqimit me drejtësinë për krimet e paraqitura në Aktakuzë, ndër të cilat përdorimi i dhunës fizike ose i kërcënimeve për dhunë, ose përpjekje për të gjetur ose nxitur të tjerë për kryerjen e akteve të dhunës

<sup>15</sup> Në rast se ky njoftim i bëhet i ditur Mbrotjtjes, ZPS-ja do të bëjë kërkesë për disa redaktime, ndër të cilat edhe emrat e dëshmitarëve.

<sup>16</sup> *Shih*. [REDAKTUAR]

<sup>17</sup> *Shih* [REDAKTUAR].

ose për kërcënim me dhunë të dëshmitarëve të cilët mbështesin akuzat kundër z. MUSTAFA në Aktakuzë, dhe kundër dëshmitarëve të tjerë të mundshëm.

#### 4. Autorizimi për kontrollim dhe sekuestrim

13. Në bazë të neneve 35(2) dhe 39(3) dhe rregullave 30-33, 37 dhe 39,<sup>18</sup> ZPS-ja bën kërkesë që në kuadër të fletarrestimit, gjykatësi i procedurës paraprake të autorizojë ZPS-në dhe/ose autoritete të tjera zbatuese të fletarrestimit që në bashkëpunim me ZPS-në (i) të kontrollojnë [REDAKTUAR]; dhe (ii) të sekuestrojnë çfarëdo prove që besohet se është përdorur në krimet e paraqitura në Aktakuzë, në lidhje me këto krime ose që mund të jetë relevante në lidhje me këto krime, veçanërisht, [REDAKTUAR]. Ndër sendet që do të sekuestrohen mund të përfshihen [REDAKTUAR].

14. Ekziston dyshim i bazuar se z. Mustafa – ish-anëtar i UÇK-së - ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara,<sup>19</sup> si edhe dyshim i bazuar se ai mund të ketë prova relevante [REDAKTUAR].<sup>20</sup> Gjithashtu, duke marrë parasysh rrezikun e ndërhyrjes dhe pengimit, sikurse u përmend më lart,<sup>21</sup> provat që mund të ketë z. MUSTAFA nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe kontrollimi e sekuestrimi në lidhje me arrestimin e tij, mund të jenë e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit.<sup>22</sup>

15. Cenimi i shkaktuar mbi të drejtën për privatësi dhe pronë të z. Mustafa është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit dhe nuk eliminon thelbin e këtyre të drejtave.<sup>23</sup> ZPS-ja do ta përshtatë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar dhe/ose informojë dhe udhëzojë siç duhet cilindo autoritet tjetër që do të kryejë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar, në një mënyrë që përjashton informacion që nuk parashikohet të jetë i rëndësishëm dhe në përputhje me garancitë e parapara në rregullën 39.

---

<sup>18</sup> *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

<sup>19</sup> *Shih gjithashtu* para.5 më lart.

<sup>20</sup> Rregulla 37(2)(a), (3).

<sup>21</sup> *Shih* para 6-12 më lart.

<sup>22</sup> Rregullat 31(1)(b), 37(1).

<sup>23</sup> Rregulla 31(1)(c).

16. ZPS-ja kërkon autorizimin e mbajtjes në ruajtje të çfarëdo prove të sekuestruar për (i) aq kohë sa është e nevojshme për vlerësimin e provave, dhe (ii) në qoftë se provat gjykohele relevante, autorizimi të zgjatet për aq kohë sa është e nevojshme për hetimet dhe procesin gjyqësor.

### 5. Zbatimi i fletarrestimit

17. ZPS-ja kërkon që fletarrestimin së bashku me autorizimin për kontrollim dhe sekuestrim, gjykatësi i procedurës paraprake t'ia transmetojë ZPS-së në bashkëpunim me Administratoren për zbatim.<sup>24</sup> ZPS-ja në bashkëpunim me Administratoren është autoriteti kompetent më i përshtatshëm për zbatimin e fletarrestimit.<sup>25</sup>

18. Për zbatimin e fletarrestimit, ZPS-ja do të marrë masat e përshtatshme për mbrojtjen dhe respektin e duhur ndaj viktimave dhe dëshmitarëve përkatës dhe ndaj të drejtave themelore të z. MUSTAFA.<sup>26</sup>

19. ZPS-ja kërkon autorizim që ta bëjë të njohur fletarrestimin për aq sa është e përshtatshme dhe e domosdoshme për zbatimin e tij.

### 6. Urdhri për transferim

20. Duke mbajtur parasysh kërkesën e ZPS-së për caktim të vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës,<sup>27</sup> ZPS-ja kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake të lëshojë urdhër për transferimin e z. MUSTAFA në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pritës, në bazë të rregullës 50(1).

C. KËRKESË PËR MOSNXJERRJE TË PËRKOHSHME TË IDENTITETEVE TË DËSHMITARËVE DHE VIKTIMAVE

21. Sikurse u parashtrua më lart, ekzistojë rreziqe reale, ndër të tjera të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe viktimave që, sipas rregullës 105, përbëjnë rrethana të veçanta që përlligjin mosnxjerrjen e përkohshme të identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave

<sup>24</sup> Rregulla 55(1).

<sup>25</sup> *Shih.* [REDAKTUAR].

<sup>26</sup> Nenet 1(2), 35(2)(f); Rregullat 30(2), 62.

<sup>27</sup> *Shih* para.3 më lart.



të përfshira në këtë proces deri kur të urdhërohen masa mbrojtëse të përshtatshme. Rrjedhimisht dhe [REDAKTUAR], ZPS kërkon që gjykatësi i procedurës paraprahe:

- i. të urdhërojë që emri dhe të dhënat identifikuese të dëshmitarëve ose viktimave të identifikuar në materialin mbështetës të mos nxirren publikisht;
- ii. të autorizojë ZPS-në që të redaktojë identitetin dhe të dhënat identifikuese dhe t'u caktojë pseudonime të përkohshme dëshmitarëve dhe viktimave të përmendura në materialin mbështetës, para se t'ua bëjë të njohura të akuzuarit ose publikut; dhe
- iii. të urdhërojë që mosnxjerrja e përkohshme të vazhdojë deri në një urdhër të mëtejshëm të gjykatësit të procedurës paraprahe me kërkesë të ZPS-së ose pasi të ketë dëgjuar ZPS-në.

#### D. KËRKESA PËR MOSNXJERRJEN E AKTAKUZËS DHE INFORMACIONIT NË LIDHJE ME TË

22. Mosnxjerrja e aktakuzës në këtë fazë është e domosdoshme për të siguruar integritetin e procesit dhe mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave. Sikurse u parashtrua më lart, ekzistojnë rreziqe reale si arratisja e z. MUSTAFA, ndërhyrja ndaj dëshmitarëve dhe viktimave dhe kryerja e krimeve të tjera që në bazë të rregullës 88(2), provojnë arsye të vlefshme që përlligjin mosnxjerrjen publike të përkohshme të Aktakuzës dhe dokumenteve e informacionit në lidhje me të deri në një urdhër të dytë.

#### E. KLASIFIKIMI

23. Ky parashtrim dhe shtojcat protokollohen si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* në përputhje me rregullat 85(4) dhe 86(2).

#### F. MASA E KËRKUAR

24. Për arsyet e lartpërmendura, ZPS-ja kërkon që gjykatësi i procedurës paraprahe:

- i. të konfirmojë Aktakuzën;
- ii. të lëshojë një fletarrestim, autorizim për kontroll dhe sekuestrim dhe urdhër për transferim sipas kushteve të parashtruara në pjesën B(4)-(6) më lart;



- iii. të urdhërojë mosnxjerrjen e përkohshme të identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave sipas kushteve të parashtruara në pjesën C më lart; dhe
- iv. të urdhërojë mosnxjerrjen e përkohshme të Aktakuzës dhe dokumenteve e informacionit në lidhje me të, sipas kushteve të parashtruara në pjesën D më lart.

**Numri i fjalëve (në origjinal) 2,119**

/nëshkrim/

**Xhek Smith**

**Prokurori i Specializuar**

E premte, 2 tetor 2020

Në Hagë, Holandë.